

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 144/124
Nr. i fq. / Br. st. - 5 -
Data: / Datum 15.07.2024
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 qershor 2024 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 11:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Hava Rruka Mlinaku (Nënkyryetare e komunës), drejtoret e drejtoreve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se përvëç materialit të rregullt, sot kanë ardhur edhe dy pika shtesë për t'i shtuar në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Draft- Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024 – 2026
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ridestinim të mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale.

Po ashtu, e kemi edhe kalendarin kohor për dëgjime publike që do ta diskutojmë, në mënyrë që mos të na shtyhet më vonë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri e futi në rend të ditës “Shqyrtimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024 – 2026”.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri e futi në rend të ditës “Shqyrtimin e Propozim – vendimit për ridestinim të mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale”.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.05.2024
2. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërbimet e nxënësve për vitin 2023/2024
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë
4. Shqyrtimi i Informatës rrëth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësítë tjera
6. Shqyrtimi i Draft- Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ridestinim të mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale
8. Pyetje dhe përgjigje
 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.05.2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 17.05.2024.

2. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se tek pjesa e përfituesve të bursave jashtë vendit, gjegjësisht tek studentët që studiojnë në Tetovë, u është dhënë një përparësi për këta studentë dhe janë ndarë bursa më shumë, në raport me studentët që studiojnë në universitetet tjera jashtë vendit. Ai tha se është dashur t'u ipet përparësi studentëve që studiojnë nëpër universitetet e vendeve të Bashkimit Evropian. Ai tha se pata propozuar që të futet në rregullore që të ndahan bursa për nxënësit “super – talent”.

Ajo që më ra në sy është se tek shkencat e natyrës nuk kishte fare aplikues dhe kjo është shqetësuese për të ardhmen, sepse nuk ka fare studentë në drejtimet si: Matematikë, Fizikë etj.

Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Arsim – tha se e falënderon komisionin për përkëtë informatë, por edhe për punën që kanë bërë në përzgjedhjen e përfituesve të bursave. Sa u përket “super-talentëve”, Tahiraj deklaroi se nuk ka rast që nuk prek “dora” e kryetarit dhe që iu i ndihmon talentëve. Ai tha se rasti i fundit është që kryetari ka përkrah nxënësit e “Inovation Academy” që kanë shkuar në Holandë.

Sa u përket profileve që nuk ka aplikues, ai tha se në të ardhmen mund të ballafaqohemi me përkëtë problem për mungesë të kuadrove profesionale në matematikë, fizikë dhe disa drejtime tjera.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se studentët përfitues brenda vendit e kanë shumën financiare 600 euro, ata jashtë vendit 800 euro, kurse 1000 euro për studentët që studiojnë në BE. Ai tha se do të ishte mirë që kjo shumë prej 800 euro të bëhet 600 euro dhe të jetë njëjtë me këta brenda vendit, ose të bëhet 800 euro edhe për këta brenda vendit, nëse janë mundësítë buxhetore, sepse nuk kisha bërë dallim.

Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Arsim – lidhur me shumën financiare që propozoi Sylejmani që mos të ketë dallim, ai theksoi se duhet të ketë dallim, sepse është distanca gjeografike dhe se kanë shpenzime më shumë këta në Tetovë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se si e kemi gjendjen me natalitet si komunë. Nëse ekzistojnë këto të dhëna do ishte mirë se do të mund të diskutojmë dhe të bëjmë analizë.

Hava Rruka Mlinaku, Nënkyryetare e komunës – tha se në faqen 4, janë regjistrimet e lindjes, martesa, vdekje dhe të dhënët tjera. Pra, për këtë periudhë po shkruan që janë 62 lindje.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – ky numër i lindjeve është shqetësues, sepse është shumë i vogël. Ajo pyeti se ky numër a është vetëm për lindjet që kanë lindur në spitalin e Vushtrrisë?

Hava Rruka Mlinaku, Nënkyryetare e komunës – deklaroi se numri i lindjeve (62) është vetëm i qytetarëve që kanë lindur në Vushtrri dhe janë regjistruar nga zyrtarët tanë të gjendjes civile. Por, jo edhe i qytetarëve të komunës sonë që kanë lindur në qytetet tjera.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – deklaroi se numrin e saktë të lindjeve të komunës sonë më së miri e gjejmë nëse i adresoheni Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, sepse aty qytetarët aplikojnë për subvencionim të lindjeve.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – ai kërkoi nga Drejtoria për Administratë që deri në seancë të kuvendit, nëse ka mundësi ta siguron numrin e saktë të lindjeve të qytetarëve të komunës sonë që kanë lindur në spitalet e komunave tjera.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Informatës rrëth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se drejtoritë duhet të bëjnë presion në Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave (AME) për kompensimin e dëmeve, sepse sa kam informacion nuk i ka proceduar pagesat. Një prej komunave më të prekura nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi është Vushtrria. Prandaj, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria e Bujqësisë t'i dërgojnë një shkresë AME-së që t'i procedon pagesat për kompensimin e dëmeve të bujqve nga fatkeqësitë natyrore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Draft- Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – deklaroi se Korniza Afatmesme Buxhetore 2025 – 2027 (KAB) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin 2025. Në këtë muaj e kemi edhe kalendarin kohor për mbajtjen e takimeve publike me qytetarë, që në bashkëpunim me anëtarët e KPF-së do t'i mbajmë këto dëgjime buxhetore. Mirëpo, këtë vit si risi te KAB-i i kemi edhe dy drejtori të reja që do të prezantohen në mbledhjen e kuvendit, ku do të plotësohen me numrin e punëtorëve, kategorinë e pagave, mallra dhe shërbime, komunali dhe investime kapitale.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – sa u përket dëgjimeve buxhetore, ne si KPF e kemi obligim që në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa t'i caktojmë anëtarët se në cilat vende do të marrin pjesë. Prandaj, nëse ka mundësi që këto dëgjime t'i përfundojmë para datës 15 korrik për shkak të pushimeve verore dhe këto takime të mbahen në orët e mbrëmjes.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – sa i përket orarit për takime, ai propozoi që Drejtoria për Administratë të konsultohet me kryetarët e këshillave lokale, sepse tash janë pushimet verore. Sa kam informacion, më datën 28 qershor i kanë ftuar në një takim kryetarët e këshillave lokale.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – tha se unë në bashkëpunim me drejtorin e financave dhe drejtoreshën e administratës do të bëjmë përpjekje të gjejë një kohë të përshtatshme me qytetarë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për”, dy (2) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ridestinim të mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se të hyrat vetanake të vittit 2023 në mënyrë automatike kanë dal në sistem, ashtu qysh ka qenë i planifikuar sistemi buxhetor dhe investimet kapitale. Ai tha se qëllimi i këtij ridestinimi është që të plotësohen ato projekte që u kemi mbetur borxh, me rastin e inflacionit në arsim, që na i kanë marrë mjetet e investimeve kapitale.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – lidhur me marrëveshjen që e ka nënshkruar komuna me qeverinë për bashkëfinancim të disa projekteve, ai pyeti se ai i ka lëshuar qeveria mjetet financiare për investimet që janë planifikuar për këtë vit dhe se komuna a i ka filluar procedurat për ato projekte.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – deklaroi se procedurat për këto projekte janë inicuar në prokurim dhe shpresojmë që në këtë muaj ato veç do të finalizohen. Mjetet financiare deri në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk kërkohen.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Pyetje dhe përgjigje.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – theksoi se e ka rastis të ndalet tek një dyqan i vogël afér shkollës dhe se është shqetësuese se aty kam parë që para nxënësve të shkollës filllore shiten dhe eksposozhen produkte farmaceutike. Këto produkte duhet të shiten vetëm në barnatore dhe vetëm me udhëzim të mjekut. Ai kërkoi nga Drejtoria për Inspektime që të inspektohen këto dyqane afér shkollave.

Jemi dëshmitarë të dëmtimeve të shumta të asfaltit. E di që po ndodhin disa projekte dhe investime, por kisha kërkuar që t'i obligoni operatorët ekonomikë që vendet ku i dëmtojnë rrugët e asfaltuara (prerjet), ta rikthejnë në gjendjen paraprake.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – deklaroi se lidhur me produktet që shiten në dyqanet afër shkollave ka qenë shqetësim i vazhdueshëm i imi personal edhe i qytetarëve tjerë që i shohin nxënësit duke blerë në këto kiosqe apo dyqane të vogla. Ajo tha se shkollave duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Po flas për shkollën “SHMU 2”, ku në të kaluarën Drejtoria për Arsim ka vendos që oborri i shkollës të jetë i mbyllur dhe nxënësit kanë hyrë në shkollë dhe nuk kanë pasur mundësi të dalin jashtë dhe të blejnë. Ka qenë një kuzhinë brenda shkollës dhe siguria e fëmijëve ka qenë shumë më e madhe. Por, Këshilli i Prindërve ka vendos që të hapet oborri i shkollës. Njëri nga anëtarët e këshillit ka qenë edhe anëtar i kuvendit dhe në kuvend ka deklaruar që fëmijtë po i dërgojmë në shkolla dhe jo në burg. E mora vetëm si shembull, por ka mundësi që në të gjitha shkollat të jetë një rend më i mirë që fëmijtë të janë të sigurt. Prandaj, edhe unë po kërkoj që inspekcioni në bashkëpunim me policinë t'i inspektojnë këto dyqane dhe të gjobiten. Këto inspektime të janë të vazhdueshme dhe të ndalohet shitja e disa artikujve në këto dyqane.

Hava Rruka Mlinaku, Nënkyetare e komunës – tha se kjo është një temë e ndjeshme që ja vlen të diskutohet, sepse të gjithë e kemi këtë shqetësim. Me inspepcionin kam biseduar për këtë çështje dhe janë duke dal shpesh në terren, e po ashtu edhe me policinë. Nga policia na kanë informuar që i kanë tkurrur mundësitet që të shiten disa produkte në “SHMU 2” dhe në gjimnazin “Eqrem Çabej” dhe se ua kanë dhënë edhe një mundësi shitésve që të punojnë. Nëse u gjendet edhe një herë shitja e këtyre substancave, do të vjen edhe te mbyllja e këtyre dyqaneve. Këtë informatë e kemi qysh para dy jave, tha ajo.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se pajtohet kjo çështje që u ngrit është shqetësuese. Por, më së miri do të ishte që Drejtoria për Arsim të vendos rregulla nëpër shkolla. Ka raste kur nxënësit e shkollave në orar të mësimit dalin nëpër qytet.

Mbledhja përfundoi në orën **12:00**.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së

